

KËRKESE

Drejtuar: GJYKATËS KUSHTETUESE

KËRKUES: Për Drejtësi Sociale, organizatë jofitimprurëse e rregjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6599, datë 14.12.2020, si dhe me seli në adresën: Rruga “Riza Cerova”, Nr.13, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari Organizatës Gentian Sejrani me kontakt gentisejrani@gmail.com

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

Ministria e Brendshme, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, Tiranë.

Këshilli i Ministrave, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

OBJEKTI:

- Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i Udhëzimit Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare” si në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe standardet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.
- Pezullimi i menjëhershëm i zbatimit të Udhëzimit Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare”, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje.
- Rikthimin e menjëhershëm të mjeteve të bllokuara tek qytetarët, të cilëve u është vendosur masa e bllokimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 38, 49, 116, 131, pika 1, shkronja “c”, 134, pika 1, shkronja “h” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 45, pika 1, 47, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Shoqata për Drejtësi Sociale, pasi ka vlerësuar përmbajtjen dhe efektet juridike të Udhëzimit Nr. 169, datë 13.10.2025, “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare”, çmon se ky akt nënligjor bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me parimet themelore të shtetit të së drejtës.

Për legjitimimin e kërkuarit

Kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Kërkuari është një shoqatë që ka si qëllim të punës, ndër të tjera të të punojë për arritjen zhvillimit të shoqërisë në atë nivel ku qytetarët, pavarësisht nga veçoritë, ose dallimet sociale, ekonomike, racore, ideologjike, krahinore, identiteti gjinor dhe në çdo aspekt tjetër midis tyre, ushtrojnë lirisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore dhe asistojnë në mënyrë të barabartë shërbimet publike, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare, të drejta që sipas tij, në rastin konkret cenohen nga dispozitat e Udhëzimit Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare”, nxjerrë nga Ministri i Ministrisë së Brendshme, prandaj interesi për kundërshtimin e tyre është i justifikuar.

Për sa i përket legjitimitetit të shoqatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e grupeve dhe objektivave që mbrojnë. Akti Normativ i këtij organi qendror i kundërshtuar në objektin e kërkesës rregullojnë marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së kërkuarës, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

Për Drejtësi Sociale është regjistruar si person juridik - organizatë jofitimprurëse - me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6599, datë 14.12.2020.

Organizata është duke zbatuar Projekte që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e tyre pranë Gjykatave Shqiptare, disa prej tyre si vijon:

- Mbrojtja ligjore si mjet për organizimin komunitar të grupeve vulnerabël.”.

- Organizimi komunitar si një mjet për promovimin e ndryshimeve ligjore në favor të përmirësimit të jetës së grupeve vulnerabil
- Shërbim juridik efikas për anëtarët e komunitetit, një biznes social.

Sipas vendimit të gjykatës dhe përmbajtjes së statutit është një organizatë jofitimprurëse që ka si mision ndër të tjera edhe:

- Të ofrojë shërbim ligjor falas, në kuadër të litigimit strategjik, në ndihmë të viktimave që u janë shkelur të drejtat themelore dhe që janë në pamundësi financiare, duke ofruar këshillim, trajtim ligjor, asistencë në përpilimin e akteve ligjore mbrojtëse dhe përfaqësim përpara organeve administrative qendrore dhe vendore, gjykatat e brendshme të gjitha niveleve si dhe gjykatave apo organizmave ndërkombëtarë relevante.
- Të nxisë llogaridhënien e administratës publike në zbatimin korrekt dhe efektiv të legjislacionit nëpërmjet denoncimit publik të cenimit të lirive dhe të drejtave të shtetasve që u përkasin grupeve në nevojë, referimit të tyre tek organet e drejtësisë shqiptare deri në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ose shkeljeve të kryera, sipas rastit.

Për rastin në shqyrtim, kërkuesi parashtroi para Gjykatës argumente në lidhje me cenimin që dispozitat e aktit normativ me fuqinë e ligjit, i miratuar nga Kuvendi - objekt i këtij kontrolli kushtetues - i bëjnë të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, të cilat kjo organizatë ka për mision që t'i mbrojë. Për pasojë kërkuesi provon interesin e tij për ta vënë në lëvizje Gjykatën, prandaj legjitimohet *ratione personae* për të iniciuar kontrollin kushtetues të aktit normative me fuqinë e ligjit objekt shqyrtimi.

SHKELJET KUSHTETUESE TË UDHËZIMIT NR. 169, DATË 13.10.2025 “PËR NDALIMIN E QARKULIMIT TË PATINAVE ELEKTRIKE OSE KOMBINIMIT TË TYRE NË RRUGË URBANE DHE TROTUARE”

1. Shkelja e parimit të proporcionalitetit në kufizimin e të drejtave themelore

Sipas nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore mund të vendosen vetëm nëse plotësohen njëkohësisht këto kushte:

- kufizimi duhet të bëhet me ligj;

- duhet të jetë i domosdoshëm për një interes publik;
- duhet të jetë proporcional me gjendjen që e ka diktuar;
- nuk duhet të cenojë thelbin e së drejtës.

Udhëzimi Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare” vendos një ndalim absolut dhe pa afat të përdorimit të patinave elektrike në rrugë urbane dhe trotuare, duke mos parashikuar asnjë mekanizëm rregullues alternativ, si p.sh.: kufizim të shpejtësisë, përdorim vetëm në korsi të dedikuara, detyrim për pajisje sigurie, kufizime në zona të caktuara.

Në këtë mënyrë, autoriteti administrativ ka zgjedhur masën më ekstreme të mundshme, duke eliminuar tërësisht përdorimin e këtyre mjeteve.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka theksuar në jurisprudencën e saj se parimi i proporcionalitetit kërkon që ndërhyrja e shtetit të jetë e domosdoshme dhe të mos tejkalojë masën e nevojshme për arritjen e qëllimit publik.

Në Vendimin nr. 20/2006, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se:

“Kufizimi i të drejtave themelore duhet të jetë i domosdoshëm dhe proporcional, duke mos tejkaluar masën e nevojshme për arritjen e qëllimit publik.”

Në rastin konkret, ndalimi total i patinave elektrike përbën një **masë disproporcionale**, pasi qëllimi i deklaruar - rritja e sigurisë në qarkullimin rrugor - mund të arrihej përmes instrumenteve më pak kufizuese.

Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar vazhdimisht se çdo kufizim i të drejtave duhet të ruajë një balancë të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave individuale.

Në çështjen Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë (1982), Gjykata theksoi se ndërhyrja e autoriteteve publike duhet të respektojë një “fair balance” midis interesit publik dhe mbrojtjes së të drejtave të individit. Udhëzimi nr. 169 nuk e realizon këtë balancë.

2. Shkelja e lirisë së lëvizjes

Neni 38 i Kushtetutës garanton të drejtën e çdo personi për të lëvizur lirshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Patinat elektrike janë bërë një mjet i zakonshëm transporti urban, veçanërisht për distanca të shkurtra, dhe përdoren nga qytetarët për shkuarjen në punë, shkuarjen në shkollë ose universitet, kryerjen e aktiviteteve të përditshme urbane.

Në shumë qytete europiane këto mjete janë integruar në politikat e transportit të qëndrueshëm dhe reduktimit të trafikut.

Ndalimi i plotë i përdorimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare krijon një pengim të drejtpërdrejtë të mënyrës së lëvizjes së qytetarëve, veçanërisht për ata që i përdorin si mjet kryesor transporti.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar në disa vendime se kufizimet mbi lirinë e lëvizjes duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale.

Në çështjen Baumann kundër Francës (2001), Gjykata theksoi se kufizimet mbi lëvizjen duhet të justifikohen nga një interes publik real dhe të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike.

Në rastin konkret nuk është kryer një analizë e rrezikut real, nuk është provuar se ndalimi total është masa e vetme e mundshme, nuk është bërë një analizë e ndikimit social dhe ekonomik.

Kjo e bën ndërhyrjen të pajustificuar dhe disproporcionale.

3. Shkelja e lirisë ekonomike

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike.

Sipas nenit 11 të Kushtetutës, sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike.

Ndërsa neni 49 garanton të drejtën e çdo personi për të fituar jetesën përmes një veprimtarie ekonomike të ligjshme.

Udhëzimi nr. 169 ka krijuar një situatë ku bizneset që importojnë dhe shesin patina elektrike janë detyruar të ndërpresin aktivitetin, mallrat e importuara kanë humbur vlerën e tyre në treg dhe është krijuar një pengesë e pajustificuar për tregtinë e këtyre produkteve.

Në praktikë, udhëzimi ka krijuar një ndalim *de facto* të tregtimit të këtyre mjeteve.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar në jurisprudencën e saj se ndërhyrjet në veprimtarinë ekonomike duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale.

Në Vendimin nr. 33/2010, Gjykata Kushtetuese theksoi se:

“ndërhyrja e shtetit në veprimtarinë ekonomike duhet të jetë e justifikuar nga një interes publik dhe të mos cenojë thelbin e lirisë ekonomike”.

Në këtë rast, ndalimi total i përdorimit të patinave elektrike ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe disproporcional mbi tregun e këtyre produkteve.

4. Shkelja e të drejtës së pronës

Sipas nenit 41 të Kushtetutës, e drejta e pronës private është e garantuar.

Po ashtu, Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garanton të drejtën e çdo personi për gëzimin paqësor të pronës së tij. Në rastin konkret qytetarët kanë blerë patina elektrike në mënyrë të ligjshme, por udhëzimi e ndalon përdorimin e tyre në hapësirat publike. Rreth 1400 mjetet të ligjshme të qytetarëve janë bllokuar si apsojë e zbatimit të këtij Udhëzimi. Kjo situatë krijon një ndërhyrje të drejtpërdrejtë në gëzimin e pronës, pasi pronarët nuk mund ta përdorin sendin e tyre për qëllimin për të cilin është blerë.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se edhe kufizimi i përdorimit të pronës përbën ndërhyrje në këtë të drejtë.

Në çështjen Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë, Gjykata theksoi se:

“çdo ndërhyrje në të drejtën e pronës duhet të ruajë një balancë të drejtë midis interesit publik dhe mbrojtjes së individit”.

Në rastin konkret, ndalimi absolut i përdorimit të patinave elektrike prish këtë balancë dhe krijon një barrë të tepruar mbi qytetarët.

5. Shkelja e parimit të sigurisë juridike

Neni 4 i Kushtetutës parashikon se Republika e Shqipërisë është një shtet i së drejtës. Një element thelbësor i shtetit të së drejtës është siguria juridike, e cila kërkon që normat juridike të jenë të qarta, të parashikueshme, të qëndrueshme.

Udhëzimit Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare” vendos një ndalim **pa afat kohor**. Ky Udhëzim nuk përcakton afatet për heqjen e ndalimit dhe nuk parashikon një regjim rregullues alternativ.

Kjo krijon një situatë pasigurie juridike për qytetarët dhe bizneset, pasi nuk dihet nëse dhe kur do të hiqet ndalimi dhe cilat do të jenë kriteret për përdorimin e këtyre mjeteve në të ardhmen.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar në jurisprudencën e saj se normat juridike duhet të jenë të qarta dhe të parashikueshme, në mënyrë që individët të mund të orientohen në sjelljen e tyre.

6. Tejkalmi i kompetencës normative dhe shkelja e hierarkisë së akteve

Sipas nenit 118 të Kushtetutës, aktet nënligjore nxirren vetëm në zbatim të ligjit dhe nuk mund të krijojnë kufizime të reja që nuk parashikohen në ligj.

Udhëzimi është një akt administrativ nënligjor, i cili nuk mund të kufizojë të drejta themelore përtej autorizimit të dhënë nga ligji.

Nëse ligji për qarkullimin rrugor nuk parashikon ndalimin absolut të patinave elektrike, atëherë udhëzimi ka krijuar një normë të re kufizuese dhe ka tejkaluar kompetencën e tij rregullatore.

Kjo përbën shkelje të parimit të hierarkisë së akteve normative.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se aktet nënligjore nuk mund të kufizojnë të drejta që Kushtetuta i garanton individëve përtej autorizimit të ligjit.

KËRKESË PËR PEZULLIMIN E MENJËHERSHËM TË ZBATIMIT TË UDHËZIMIT NR. 169, DATË 13.10.2025 “PËR NDALIMIN E QARKULLIMIT TË PATINAVE ELEKTRIKE OSE KOMBINIMIT TË TYRE NË RRUGË URBANE DHE TROTUARE”

Kërkuesi kërkon nga gjykata pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të Udhëzimit Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare”, deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

Kjo kërkesë bazohet në nenin 45 të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, sipas të cilit gjykata kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

Në rastin konkret, ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore për vendosjen e kësaj mase sigurimi.

- Zbatimi i menjëhershëm i udhëzimit të kundërshtuar po shkakton dhe rrezikon të vazhdojë të shkaktojë dëme të konsiderueshme dhe të pariparueshme për qytetarët dhe subjektet ekonomike.
- Zbatimi i udhëzimit vazhdon të prodhojë pasoja negative të drejtpërdrejta mbi jetën e përditshme të qytetarëve.
- Autoritetet kanë ndërmarrë edhe bllokimin e këtyre mjeteve, duke krijuar një ndërhyrje të drejtpërdrejtë në të drejtën e pronës. Kjo përbën një situatë që shkakton dëme të vazhdueshme për qytetarët, të cilat nuk mund të kompensohen plotësisht në të ardhmen.

PËRFUNDIM

Nga analiza e mësipërme rezulton se Udhëzimi Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare”

- cenon lirinë e lëvizjes së qytetarëve;
- cenon lirinë ekonomike dhe veprimtarinë e ligjshme tregtare;
- ndërhyr në të drejtën e pronës;
- shkel parimin e proporcionalitetit;
- cenon sigurinë juridike;

- tejkalon kompetencën normative të autoritetit administrativ.

Për rrjedhojë, ky akt është i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe standardet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, **dhe si i tillë kërkohet:**

- Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i Udhëzimit Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare” si në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe standardet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.
- Pezullimi i menjëhershëm i zbatimit të Udhëzimit Nr. 169, datë 13.10.2025 “Për ndalimin e qarkullimit të patinave elektrike ose kombinimit të tyre në rrugë urbane dhe trotuare”, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje.
- Rikthimin e menjëhershëm të mjeteve të bllokuara tek qytetarët, të cilëve u është vendosur masa e bllokimit.

KËRKUESI

PËR DREJTËSI SOCIALE

Kryetar i Organizatës

Gentian Sejrani